

Data: _____

PROCES VERBAL ARGUMENTIMI

Tipi i kontratës

Sherbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

Mirëmbajtje dhe vlerësimi i cënueshmerisë (vulnerabiliteteve), si dhe i ekspozimit kundrejt risqeve kibernetike për të dhënat e sistemeve IT.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Mirëmbajtja e softwareve të teknologjisë së informacioni – 72267100 – 0.

VLERA E FONDIT LIMIT:

69,473,333 (Gjashtëdhjetë e nënte milionë e katërqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) leke pa TVSH ose 723,003 (Shtatëqind e njezet e tre mijë e tre) euro pa TVSH, ***Sipas kursit zyrtar te dates 10.04.2026 ku 1 euro = 96.09 leke.***

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim të vena në dispozicion nga grupi i punës, caktuar me urdher titullari për këtë proces, për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur që kjo procedure të mos jete në lotë sipas arsyetimit të mëposhtëm:

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike është lider në shpërndarjen e energjisë elektrike në Republikën e Shqipërisë. Për momentin OSHEE sh.a. ka në tërësi disa nga infrastrukturën më të rëndësishme dhe komplekse të IT-së në vend. Duke iu referuar rëndësisë që furnizimi me energji ka në jetën e sotme sociale-ekonomike, infrastruktura e OSHEE-së mund të konsiderohet jetike, me një ndikim të gjerë në jetën e përditshme të Shqipërisë.

Në të kaluarën, sistemet e IT ishin të izoluar, ndërsa sfida e sotme është lidhja e disa sistemeve së bashku nëpërmjet shkëmbimit të vazhdueshëm të të dhënave të shumëfishta. Ky shkëmbim gjithnjë në rritje i të dhënave dhe faktorëve të tjerë, përbëjnë një rrezik të madh për infrastrukturën e OSHEE-së në aspektin e Sigurisë Kibernetike.

Ndër objektivat parësore të OSHEE-së është siguria e furnizimit të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm të energjisë. Lëvizja drejt sistemeve më të ndërlidhura, të decentralizuara me një numër në rritje të pjesëmarrësve, shërbime të reja dhe bashkëpunim të zgjeruar ndërkufitar, sjell sfida të shumta për sigurinë e furnizimit me energji dhe funksionimin e sigurt të infrastrukturës energjetike. Një nga sfidat është sigurimi nga risqet kibernetike në kohën e aplikimit në rritje të teknologjive digjitale të informacionit dhe të komunikimit në sektorin e energjisë.

Qëllimi kryesor i projektit është implementimi i një sërë masash teknike për rritjen e sigurisë së sistemeve kritike, të rëndësishme dhe të gjitha sistemeve të tjera të infrastrukturës IT në përdorim nga OSHEE.

Masat teknike do të implementohen në disa prej kategorive më kryesore të përcaktuara në dokumentat e referencës për ligjin e sigurisë kibernetike dhe menaxhimin e sigurisë së sistemeve të OSHEE që janë:

- Menaxhimi i aseteve IT
- Mbrojtja e integritetit të rrjeteve të komunikimit dhe sistemeve IT
- Zbulimi i ngjarjeve të sigurisë kibernetike

Nisur nga procesi i kompleks i punës ky objekt nuk mund të ndahet në lote, pasi është e pamundur të ndash përgjegjësitë dhe Kohën e reagimit në rast problem, gjithashtu, Autoriteti Kontraktor mundëson për punonjësit përgjegjës të operatorit ekonomik të kontraktuar vetëm të drejta hyrje të përkohshme fizike apo në largësi në sistemet TIK që preken shërbimi i mirëmbajtjes.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenin 26 dhe 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike për realizimin e objektit të prokurimit, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 69,473,333 (Gjashitëdhjetë e nëntë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) leke pa TVSH.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti / enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në Nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe në Nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, ku përcaktohet se: Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Lloji i procedurës është “e hapur Sherbime – mbi kufirin e larte monetar” me mjete elektronike”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të Nenit 43, pika 2, gërma” a” të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: ”Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

1. dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar të xhiros (jo më e vogël se 100% e vlerës së fondit) është Brenda marzhit të lejuar që mund të kërkohet. Gjithashtu për të stimuluar të gjithë operatorët e rinj që operojnë në treg si dhe për rritur numrin e konkurrentëve në këte procedure është gjykuar që vlera e xhiros se kërkuar të jete minimalisht sa 100% e vlerës së parashikuar të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, ku përcaktohet se: ”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Ndër të tjera, përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u mbështetur gjithashtu dhe në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", I ndryshuar, VKM Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", I ndryshuar.

Përkatësisht në miratimin e këtij kriteri është mbajtur në vëmendje neni 29 i Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” ku përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin

kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet te kete nje aktivitet pozitiv te qendrueshem gjate 3 (tre) viteve te fundit 2023, 2024, 2025. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit, të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve gjithashtu te jene të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve te nenit 41, pika” c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Referuar Nenit 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore “përcaktohet se:” Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:*

i)totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per shërbimet te mëparshme të ngjashme për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates në nje vlere jo më të vogel se 27,000,000 (Njzet e shtate milion) leke pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- *Për përvoja te mëparshme të realizuar me sektorin publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara ne organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe **shërbimet e realizuara**.*
- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe **shërbimet e realizuara**".*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që përvoja të ngjashme të jenë ne vlerën jo më shumë se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marre ne konsiderate faktin qe te krijohen kushtet per nje konkurrence te hapur dhe per te mos minimizuar artificialisht numrin e operatoreve ekonomik qe ofrojnë këto lloj pervojash, pavaresisht rendesise dhe kompleksitetit te objektit te procedures te prokurimit, bazuar dhe ne frymen e konkurueshmerise qe gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlera e kërkuar qe OE ofertues te ketë realizuar me kontrata te ngjashme, te jetë nen 40 % e vlerës dhe ne këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë qe OE ofertues do jete realisht ne gjendje te realizoje kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurinë e punës se AK, e cila ka ne funksionim nje seri sistemesh te nderlidhura dhe te informatizuara e teknologjise se larte dhe me impakt shume te madh financiar ne rast bllokimi apo mos-funksionimi.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 9001:2015 ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (të vlefshme), ISO 27001:2022 ose ekuivalente per sistemin e menaxhimit te sigurise se informacionit (e vlefshme) dhe ISO 20000-1 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të shërbimit të teknologjisë së informacionit. (të vlefshme).

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM - 285 date 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprahe

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Konkretisht:

Kërkesa Lidhur me certifikimin ISO 9001:2015 ose ekuivalent, na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë.

Përkatësisht kjo lloj ISO specifikon kërkesat për një sistem cilësor të menaxhimit të cilësisë, kur një organizatë:

- Duhet të dëshmojë kapacitetin për të siguruar vazhdimisht produktin që kënaq klientin dhe kërkesat staturore dhe normative të aplikueshme.
- Synon të përmirësojë kënaqjen e klientit, nëpërmjet aplikimit të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe garancisë të konformitetit me klientin dhe kërkesat staturore dhe normative të aplikueshme.

Kërkesa Lidhur me certifikimin ISO 27001:2022 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe e kanë një rëndësi dhe konfidencialitet të lartë) të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikepamja informatike dhe të jenë të kontrolluara si dhe aksesimi i tyre të jetë i verifikueshëm. Kjo vjen pasi në këto kontrate do të kryesohet vijimi i mirëmbajtjes dhe upgrade të sistemeve ekzistuese që kërkojnë kompetencë të shtuar profesionale në këto drejtim, pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe në kategorinë e mbrojtjes kibernetike.

Kërkesa Lidhur me certifikimin ISO 20000-1 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar, është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke qenë se zoteron një sistem menaxhimi për shërbimet e teknologjise së informacionit, duke pasur me shumë garanci që ky i fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirëmbajë dhe përmirësojë të gjithë sistemin në teresi i cili është teresisht i bazuar në produkte TIK (software dhe hardware), pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe në kategorinë e mbrojtjes kibernetike.

2.3.3 Operatori pjesëmarrës për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike objektin e prokurimit, duhet të vërtetojë se ka të punësuar ose me kontratë bashkëpunimi jo më pak se 10 (Dhjetë) punonjës të diplomuar në degët e Inxhinierisë Elektronike / Inxhinieri Informatike / Teknologji Informatike / Informatikë / Informatikë Matematikë / Inxhinieri Matematike dhe Informatikë, Informatikë Ekonomike / Telekomunikacion / Inxhinieri Telekomunikacion, që do të angazhohen në implementimin e projektit. Stafit të jetë i vërtetuar me kontratë individuale pune midis paleve të vlefshme, diplomë përkatëse, Çertifikate përkatëse / Transkriptet si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, nga të cilet:

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim projektsh, PRINCE2 ose ekuivalent.
- b) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për ITIL, në menaxhimin e shërbimeve IT, ose ekuivalent.
- c) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për testime të automatizuara.
- d) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për konfigurimin dhe administrimin e mjediseve virtuale Windows, VMware ose ekuivalent.
- e) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar si administratorë të sigurisë së rrjeteve në nivel profesional.
- f) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për Cybersecurity
- g) Të paktën 1 (një) person të certifikuar si Lead Auditor në fushën e sigurisë së informacionit
- h) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për administrimin dhe menaxhimin e serverëve.

Një punonjës mund të jetë i certifikuar në një apo me shumë certifikata të percaktuara si mësipërme.

Për të përmbushur këto kritere, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Lidhur me kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të 21 Shtuar me VKM 498/2024 22 Shtuar me VKM 498/2024 30 këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit dhe nenit 41 pika 4 paragrafet b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin minimal të nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

Argumentimi teknik:

Oellimi dhe objektivi final i ketyre kriterëve është mosnderprerja e shërbimeve shume të rëndësishme të ofruara përfitë nga punonjësit dhe sistemet teknologjike të Oshee Group sha, sigurimi i vijmësise së punës, mos rrezikimi i ekspozimit të të dhenave konfidenciale që përmbajne/grumbullojne e menaxhojne keto sisteme dhe sigurisht minimizimi maksimal i humbjeve të pallogaritshme financiare zinxhir që do shkaktoheshin në rast nderprerjeje të proceseve të përditshme të punës si rezultat i mos-kryerjes së ketij prokurimi, në kuader të progresit të vazhdueshëm e të pandalshëm teknologjik faktik të platformave ekzistuese dhe atyre që do vijne në të ardhmen e afert për Oshee Group sha.

Kriteri garanton AK për aftësitë profesionale të punonjësve që ka OE.

Argumentim për kriterin në piken a):

Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim projektsh, PRINCE2 ose ekuivalent. Ky kriter gjykohet se është i domosdoshëm në kushtet e madhësisë dhe kompleksitetit të realizimit të kontratës dhe rëndësisë operacionale që kanë sistemet të AK, ku të gjitha këto duhet domosdoshmerisht të ndiqen nga një profesionist i kualifikuar PRINCE2 ose ekuivalent në menaxhimin e projekteve nga fillimi (nenshkrimi i kontratës) deri në përfundim të saj, në mënyrë që të minimizohet në maksimum risku i mosrealizimit të kontratës për arsye menaxheriale. Ky lloj certifikimi është standard i kërkuar gjerësisht, dhe garanton Autoritetin Kontraktor të OE kapacitetet menaxheriale, njohuri dhe ekspertize të thelluar në menaxhimin e projekteve, kredibilitet profesional si dhe shërbim si një pikë referuese nga ana e AK gjatë zbatimit të kontratës

Argumentim për kriterin në piken b):

Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për ITIL, në menaxhimin e shërbimeve IT, ose ekuivalent. Te paktën 2 (dy) punonjës të pajisur me Certifikate për menaxhimin e shërbimeve ITIL ose ekuivalente, është e nevojshme që OE të ketë një stafin e tij, këtu specialist duke garantuar AK për mosnderprerje të shërbimit dhe vijmësine e punës. Bejme sqarimin se certifikimet multinacionale janë teper të specializuara dhe të dedikuara, ndaj duhet të jenë të njëjta certifikimet e kërkuara nga AK. Kjo shërbim për të tërhequr vëmendjen e operatoreve ekonomik që të jete teper të specializuar në certifikimet që do paraqesin bashkë me ofertën. Specialistet kërkohen për të implementuar, suportuar si dhe për të mirëmbajtur zgjidhjen, e cila është relativisht voluminoze dhe me koheshtrirje vjetore

Argumentim për kriterin në piken c):

Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për testim të automatizuar.

Ky kriter gjykohet se është i domosdoshëm në kushtet e madhësisë dhe kompleksitetit të realizimit të kontratës, si dhe rëndësisë operacionale që kanë sistemet për Autoritetin Kontraktor. Prania e të paktën dy specialistëve të certifikuar në testim të automatizuar siguron mbulim të plotë të proceseve të testimit, vazhdimësi në punë dhe reduktim të varësisë nga një individ i vetëm. Angazhimi i dy ekspertëve mundëson ndarjen e efikasë të detyrave, zhvillimin paralel të skripteve

të testimit, si dhe verifikimin e ndërsjellë të rezultateve, duke rritur cilësinë dhe besueshmërinë e testeve. Gjithashtu, kjo garanton reagim më të shpejtë ndaj problematikave dhe përmbushje të afateve të kontratës. Ky lloj certifikimi përbën një standard të njohur dhe të kërkuar gjerësisht, dhe garanton për Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik disponon kapacitetet teknike, njohuritë dhe ekspertizën e nevojshme për të realizuar teste të automatizuara në përputhje me praktikën më të mira të industrisë, duke minimizuar riskun e mosrealizimit të kontratës për arsye teknike.

Argumentim per kriterin ne piken d):

Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për konfigurimin dhe administrimin e mjediseve virtuale Windows, VMware ose ekuivalent.

Ky kriter gjykohet se është i domosdoshëm duke marrë në konsideratë kompleksitetin teknik të infrastrukturës dhe rëndësinë kritike që kanë mjediset virtuale në funksionimin e sistemeve të OSHEE Group sh.a. Administrimi i këtyre mjediseve kërkon njohuri të specializuara dhe aftësi të avancuara për të garantuar funksionim të qëndrueshëm, të sigurt dhe me performancë të lartë.

Prania e të paktën dy specialistëve të certifikuar siguron vazhdimësi operationale dhe shmang varësinë nga një individ i vetëm, duke mundësuar mbulim të plotë në rast mungese apo situatash emergjente. Gjithashtu, mundëson ndarje efikase të detyrave, monitorim të vazhdueshëm dhe reagim të shpejtë ndaj incidenteve teknike, duke minimizuar ndërprerjet e shërbimeve.

Certifikimet në teknologji si Windows Server, VMware ose ekuivalente përbëjnë standarde të njohura ndërkombëtarisht dhe garantojnë për OSHEE Group sh.a se Operatori Ekonomik disponon kapacitetet teknike, ekspertizën dhe besueshmërinë e nevojshme për menaxhimin e mjediseve virtuale, duke reduktuar në maksimum riskun e dështimeve teknike dhe duke siguruar qëndrueshmërinë e sistemeve gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Argumentim per kriterin ne piken e):

Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar si administratorë të sigurisë së rrjeteve në nivel profesional.

Ky kriter gjykohet se është i domosdoshëm duke marrë në konsideratë rëndësinë kritike të sigurisë së rrjeteve dhe të sistemeve që mbështesin operacionet e OSHEE Group sh.a. Mbrojtja e infrastrukturës nga kërcënimet kibernetike, menaxhimi i incidenteve dhe garantimi i integritetit, konfidencialitetit dhe disponueshmërisë së të dhënave kërkojnë ekspertizë të specializuar në nivel profesional. Prania e të paktën dy specialistëve të certifikuar siguron vazhdimësi operationale, mbulim të vazhdueshëm dhe reagim të shpejtë ndaj incidenteve të sigurisë, duke shmangur varësinë nga një individ i vetëm. Gjithashtu, mundëson ndarje të detyrave, monitorim të vazhdueshëm të rrjetit dhe implementim korrekt të politikave dhe kontroleve të sigurisë. Certifikimet profesionale në sigurinë e rrjeteve përbëjnë standarde të njohura ndërkombëtarisht dhe garantojnë për OSHEE Group sh.a se Operatori Ekonomik disponon kapacitetet teknike, njohuritë dhe ekspertizën e nevojshme për të menaxhuar dhe mbrojtur infrastrukturën e rrjetit, duke minimizuar riskun e incidenteve të sigurisë dhe duke siguruar funksionim të qëndrueshëm gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Argumentim per kriterin ne piken f):

Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për Cybersecurity
Ky kriter gjykohet se është i domosdoshëm duke marrë në konsideratë kompleksitetin dhe rëndësinë kritike të sigurisë kibernetike në infrastrukturën e OSHEE Group sh.a. Zgjidhjet e sigurisë shpesh bazohen në teknologji specifike të prodhuesve, të cilat kërkojnë njohuri të thelluara dhe të certifikuara për konfigurim, administrim dhe reagim ndaj incidenteve. Prania e të paktën dy specialistëve të certifikuar nga prodhuesi siguron përdorim korrekt dhe optimal të teknologjive të implementuara, si dhe garanton vazhdimësi operacionale dhe mbulim të plotë në rast mungese apo situatash emergjente. Kjo gjithashtu mundëson ndarje të detyrave, monitorim të vazhdueshëm dhe reagim të shpejtë ndaj kërcënimeve kibernetike. Certifikimet nga prodhuesi përbëjnë një standard të lartë profesional dhe garantojnë për OSHEE Group sh.a se Operatori Ekonomik disponon ekspertizë të drejtpërdrejtë mbi teknologjitë e përdorura, duke minimizuar riskun e konfigurimeve të pasakta, dobësive të sigurisë dhe ndërprerjeve të shërbimit, si dhe duke siguruar një nivel të lartë mbrojtjeje gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Argumentim per kriterin ne piken g):

Të paktën 1 (një) person të certifikuar si Lead Auditor ne fushen e sigurise se informacionit.

Ky kriter gjykohet se është i domosdoshëm duke marrë në konsideratë nevojën për vlerësim të pavarur dhe të strukturuar të masave të sigurisë së informacionit në infrastrukturën e OSHEE Group sh.a. Roli i një Lead Auditor-i të certifikuar është thelbësor për të garantuar që politikat, procedurat dhe kontrollet e sigurisë janë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kërkesat ligjore në fuqi.

Angazhimi i një profesionisti të certifikuar siguron kryerjen e auditimeve të rregullta, identifikimin e dobësive dhe rekomandimin e masave për përmirësim, duke kontribuar në rritjen e nivelit të sigurisë dhe në menaxhimin efektiv të risqeve.

Ky lloj certifikimi përbën një standard të njohur ndërkombëtarisht dhe garanton për OSHEE Group sh.a se Operatori Ekonomik disponon ekspertizën dhe pavarësinë profesionale të nevojshme për të monitoruar dhe vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme elementet e sigurisë së informacionit, duke minimizuar riskun e shkeljeve të sigurisë dhe duke siguruar përputhshmëri me praktikatat më të mira të industrisë gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Argumentim per kriterin ne piken h):

Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për administrimin dhe menaxhimin e serverëve.

Ky kriter gjykohet se është i domosdoshëm duke marrë në konsideratë rëndësinë kritike që kanë serverët në funksionimin e sistemeve dhe shërbimeve të OSHEE Group sh.a. Administrimi i serverëve kërkon njohuri të avancuara për konfigurim, mirëmbajtje, monitorim dhe siguri, me qëllim garantimin e disponueshmërisë dhe performancës së lartë të sistemeve. Prania e të paktën dy specialistëve të certifikuar siguron vazhdimësi operacionale dhe shmang varësinë nga një individ i vetëm, duke mundësuar mbulim të plotë në rast mungese apo situatash emergjente. Gjithashtu, mundëson ndarje efikase të detyrave, reagim të shpejtë ndaj incidenteve dhe mirëmbajtje proaktive të infrastrukturës. Certifikimet për administrimin e serverëve përbëjnë

standarde të njohura dhe të kërkuara gjerësisht, duke garantuar për OSHEE Group sh.a se Operatori Ekonomik disponon kapacitetet teknike, ekspertizën dhe besueshmërinë e nevojshme për menaxhimin e serverëve, duke minimizuar riskun e ndërprerjeve të shërbimeve dhe duke siguruar funksionim të qëndrueshëm gjatë gjithë periudhës së kontratës.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë zgjidhjen teknike sipas kërkesave të parashikuara në Dokumentet e Tenderit në të cilën të përfshihet propozimi i një draft plani të detajuar për shërbimet e implementimit dhe konfigurimit të pajisjeve dhe sistemeve që janë objekt prokurimi.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në lidhje me kriteret teknike dhe është në përputhje me Nenin 36 dhe Nenin 79 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Nenin 44 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.3.5. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose distributori të autorizuar për të gjitha licensat e kërkuara. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax, email, website, këto të nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

Argumentimi: Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalin zyrtar të origjinës së produkteve/licensimeve specifike që kërkohen në procedurë, na garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre produkteve/shërbimeve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të produkteve / shërbimeve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve me të larta nga prodhues me fame të mirë botërore dhe të zyrtarizuar në praktikën e tyre të veprimtarisë tregtare. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë autorizimet perkatese për furnizimin e produkteve/shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributorët perkates si dhe që do vijojnë për të zbatuar kushtet e garancisë. Duke qenë se një pjesë me dërrmuese e prokurimit është vazhdimësi për sisteme ekzistuese që janë funksionale dhe tepër të rëndësishme. Operatorët Ekonomikë duhet specifikisht të paraqesin Autorizimet e Prodhuesit/Distributorit nga prodhuesit/distributorët të kanalit zyrtar perkates me qëllim që të garantojnë Autoritetin Kontraktor se këta operatorë ekonomikë kanë të drejtë për të rishitur këto produkte/licensa/shërbime, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e procesit nga të njëjtët prodhues.

Argumentimi i specifikimeve dhe termave te references

Shënim: specifikimet teknike, për shërbimin objekt prokurimi, të cilat shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha shërbimeve dhe të pajisjeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e shërbimit, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku çdo referencë shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”, janë pjese ne DST e kesaj procedure.

Në specifikimet teknike, objekti i kontratës, nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

***Shënim:** në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, në mbështetje të përcaktimit të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që **“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,** autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”, për rrjedhojë, ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të plotesoje sa mesiper.*